



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

KF.nr.59/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “NAS System” Sh.P.K. me seli në Gjilan , të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Alban Makolli avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 29,813.37 € , në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me 22.04.2024, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit av. Alban Makollin dhe përfaqësuesit të palës së paditur Lumturie Xhaka, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses “NAS System” Sh.P.K. me seli në Gjilan, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr. nr.520/2019 i datës 31.12.2019 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditëses “NAS System” Sh.P.K. me seli në Gjilan t’ia kthej mjetet në shumë të përgjithshme prej 28.580.05 euro në emër të tatimit shtesë (PD- tatimi në Burim dhe TVSH- Tatimi në Vlerën e Shtuar) të vendosur për periudhën 2012-2014, me kamate ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga paditësi dhe datën kur e paditura e referon për pagesë-rimbursim Ministrisë së Financave, si dhe detyrohet e paditura t’ia njeh paditësit shumën prej 8,470.21 euro në emër të zvogëlimit të kreditimit.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë me datë 18.12.2019, ka iniciuar procedurën për heshtje administrative, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 02.12.2021 ka deklaruar se padinë për heshtje administrative gjykata ta konsideroi si padi për anulimin e vendimit nr.520/2019 i datës 31.12.2019, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë. Duke e zgjeruar padinë edhe në aktin e nxjerrë më vonë nga e paditura. Ka theksuar se e paditura pa drejtësisht e ka ngarkuar me tatim shtesë paditësin për periudhën 03/12 deri më dt.03//14 në lidhje me shpenzimet e faturave blerëse përgjatë këtij shqyrtimi kërkojmë nga gjykata që të administrohen të gjitha provat e propozuara në padi, ku nga ekspertiza financiare e në lëndën A.nr.255/16 sipas aktvendimit të dt.15.11.18 e dorëzuar në gjykatë me dt.11.12.18, e cila e sqaron në detaje se faturat kanë qenë reale, pagesat janë bërë përmes xhirollogarive dhe se të gjitha projektet qoftë sipas faturave blerëse ashtu edhe faturave shitëse janë realizuar në tërësi përmes të cilës vërtetohet se ngarkimi me tatim shtesë, interes financiar dhe ndëshkim ndaj paditësit është bërë pa të drejtë. Po ashtu fakt që vlen të potencohet është ai i mungesës së certifikatës së TVSH-së i subjekteve me të cilat paditësi ka pasur raporte kontraktuale ku e paditura e ka konstatuar një gjë të tillë, por që në fakt eksperti ka dhënë sqarimin se gjatë periudhës 2012-2014 të gjitha këto subjekte e kanë pasur në rregull certifikatën e TVSH-së në kohën kur këtu paditësi ka pasur marrëdhënie kontraktuale me ta dhe se të gjitha transaksionet kanë qenë reale. Gjatë seancës gjyqësore të udhëhequr në procedurën e rigjykimit përfaqësuesi i palës paditëse ka shtuar se lidhur me aktakuzën e dorëzuar nga e paditura askund nuk bën fjalë se paditësi ose përfaqësuesi i saj janë pjesë e kësaj aktakuzë, në to nuk përshkruhet asnjë faturë që është objekt shqyrtimi në këtë rast. Më tej ka theksuar se paditësi ka blerë mallra dhe jo shërbime dhe se këto mallra janë shitur tutje te institucionet publike dhe pagesat janë pranuar nga të njëjtat. Lidhur me dokumentacionin e dorëzuar nga e paditura ka theksuar se fakti që të njëjtat nga data 2015 nuk i janë dorëzuar paditësit dhe fakti vendimtar se në këtë aktakuzë nuk është përfshirë paditësi as faturat kontestuese konsiderojnë se këto prova janë jo relevante dhe nuk duhet të merren në konsideratë. Kërkesëpadinë e ka precizuar duke kërkuar që të aprovohet në tërësi e themelet kërkesëpadia, të anulohet i paligjshëm vendimi nr.590/2019 i marr në rivendosje nga e paditura dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kthej mjetet në shumë të përgjithshme prej 28.580.05 euro në emër të tatimit shtesë (PD- tatimi në Burim dhe TVSH- Tatimi në Vlerën e Shtuar) të vendosur për periudhën 2012-2014, me kamatëvonesë ligjore të llogaritur nga data e përmbushjes së plotë të pagesës 29.08.2016 e tutje e deri në pagesën definitive, e konstatuar sipas ekspertizës financiare të punuar nga M.P. me datë 11.12.2018 dhe

të detyrohet e paditura t'ia njeh edhe shumën prej 8,470.21 euro në emër të zvogëlimit të kreditimit.

E paditura në përgjigje në padi i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paraqitura të paditësit si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale, dhe vlerëson se vendimi i DA të ATK-së nr. 520/19 i datës 31.12.2019 është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në republikën e Kosovës, mbështetur në argumentet si vijon: ATK-ja ka duke respektuar rekomandimet e Gjykatës sipas aktgjykimit A.nr. 255/2016, ka nxjerr vendimin nr. 63/2019 të datës 02.04.2019, mirëpo për arsyet se ATK-ja nuk ka pasur informata se paditësi ka bërë ankesë në gjykatën e apelit ndaj këtij aktgjykimi, DA-ja është obliguar me vendimin pasues nr. 520/19 të datës 31.12.2019 ta bëjë anulimin e vendimit nr. 63/2019 të datës Numri i lëndës:2019:292994 Datë: 17.12.2021 Numri i dokumentit: 02524393 3 (9) 2019:292995 02.04.2019, tutje pas kësaj respektivisht Aktgjykimit AA.nr.317/2019 të Gjykatës së Apelit, DA-ja ka respektuar në tersi rekomandimet e aktgjykimit dhe ka nxjerr vendimin nr. 520/19 të datës 21.12.2019, sipas detyrës zyrtare, dhe se pretendimi i paditësit për heshtje administrative nuk është i bazuar. Tutje thekson se ndaj bizneseve nga të cilat paditësi ka pranuar fatura të cilat nuk i janë njohur si shpenzime, në bazë të Aktakuzës PPS nr. 73/14 të datës 24.05.2018, të Prokurorisë Themelore Prishtinë – Departamenti për krime të Rënda është duke u zhvilluar procesi gjyqësor në lëndën nr. P.nr.5548/18 nën dyshimin për lëshim të faturave dhe transaksioneve fiktive, pra duke lëshuar fatura të cilat në kuptimin ligjor i përmbajnë të gjitha elementet ligjore por në fakt nuk ka ndodhur shkëmbim i mallrave dhe shërbimeve por vetëm lëshim i një fature (letre), e cila paraqet transaksion fiktiv dhe këto persona dyshohet se kanë përfituar vetëm një përqindje të caktuar për këto transaksione fiktive sepse iu kanë mundësuar bizneseve të ndryshme të bëjnë rritje të shpenzimeve në TVSH-ë dhe TAP-ë në mënyrë të kundërligjshme. ATK-ja vlerëson se vlerësimi zyrtar është bërë konform nenit 14, 15 dhe 19 të ligjit nr. 03/L-222, dhe se kontestin e tatimpaguesit për mospranimin e faturave kontestuese e ka bazuar në faktin se për këto blerje paditësi nuk ka arritur ti vërtetoj me akte tjera të parapara ligjore si deklarim të blerjeve mbi 500.00 euro., siç parashihet me par 3 të nenit 47 të Ligjit nr. 03/L-222. andaj i propozon Gjykatës që ta refuzoj në tersi si të pa bazuar padinë e paditësit dhe ta vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin e DA të ATK-së nr. 520/19 të datës 31.12.2019. Gjatë seancës gjyqësore të mbajtur në rigjykim dhe në fjalën përfundimtare ka shtuar se paditësi nuk ka ofruar dëshmi se faturat kanë qenë të regjistruara në librat e shitjes dhe blerjes, po ashtu nuk ka ofruar dëshmi se këto fatura janë deklaruar ashtu siç e kërkon legjislacioni tatimor se transaksionet mbi 500 euro bazuar në nenin 47 par 3 të Ligjit 03/L-222 e parasheh që të gjitha transaksionet mbi 500 euro të kalojnë

përmes bankës, një provë të tillë nuk ka arritur të dëshmoj. Ka shtuar se në seancën e kaluar është dorëzuar raportit it kontrollit DHTI i dt 03.08.2015, bazuar në këtë raport shihet se paditësi është pjesë e faturave fiktive ku dhe është ngritur aktakuza për këtë çështje. Prandaj të gjitha të gjeturat e ATK-së janë të bazuara , të ligjshme, kanë mbështetje ligjore dhe është konstatuar saktë gjendja faktike gjë për të cilën paditësi nuk ka arritur me asnjë fakt apo provë të dëshmojë të kundërtën.. Sa i përket ekspertizës financiare të datës 11.12.2018 kërkojmë nga gjykata që mos t'ia falë besimin kësaj ekspertize financiare sepse eksperti nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike dhe transaksionet. Nuk ka arritur as sot në këtë seancë se ka bërë verifikim të transaksioneve bankare dhe nuk e ka vërtetuar anën formale të këtyre faturave duke mos u përgjigjur pyetjeve që i janë shtruar ose duke u përgjigjur pjesërisht në mungesë të fakteve të argumentueshme për këtë proces gjyqësor, pra eksperti financiar ka dështuar që të bëjë detyrën e tij që është vërtetimi i saktë i gjendjes faktike me kërkesë për gjykatën që të lë në fuqi vendimin e DA me nr. 520/2019 të dt. 31.12.2019 dhe të refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të pabazuar dhe pa mbështetje ligjore dhe po ashtu të mos ia fal besimin ekspertizës financiare të punuar nga eksperti financiar.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke vepruar sipas ankesës së paditësit ndaj aktgjykimit A.nr.3031/19 të datës 02.12.2021, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr 1074/22, të njëjtën e ka aprovuar ashtu që ka prish Aktgjykimin e Divizionit Fiskal të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.3031/19 të datës 02.12.2021, dhe të njëjtën i ka kthyer dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate për rishqyrtim dhe rivendosje. Me vërejtje se në ri-procedurë gjykata duhet të vërtetoj saktë gjendjen faktike, të bëjë administrimin dhe vlerësimin e të gjithave provave materiale veç e veç dhe në mënyrë të tërësishme, ato që gjenden në shkresat e lëndës duke e administruar dhe vlerësuar si provë ekspertizën financiare, e varësisht nga rrethanat dhe vlerësimi i fakteve nga ekspertiza gjykata mund të kërkoj nga eksperti financiar sqarime plotësuese lidhur me faturat dalëse dhe stoqet e regjistruara të paditësit për periudhën kontestuese përmes të cilave vërtetohet nëse këto transaksione kanë ndodhur në të vërtet dhe më pas në mënyrë të drejtë të zbatoj të drejtën materiale, në vlerësimin e ligjshmërisë së nxjerrjes së vendimit të të paditurës gjatë procedurës administrative, konform nenit 43 par. 1 dhe 2 të LKA -së, dhe mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, të sjell një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, dhe një dispozitiv të qartë, të kuptueshëm dhe të përmbarueshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 22.04.2024, ka administruar provat si në vijim: Procesverbali i datës 02.12.2021 në lëndën A.nr. 3031/19, Provat e bashkangjitura

ankesës të datës 01.02.2022, Raporti final hetues i datës 03.08.2015, ekspertizë financiare e datës 15.09.2015, Aktakuzë PPS nr.73/14.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues nr.520/19, Gjykata konstaton se e paditura Departamenti i Ankesave-ATK, e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar vendimin nr. 441/2015 të datës 29.01.2016. Divizioni i ankesave pranë ATK-së ka konstatuar se vlerësimi zyrtar është bërë konform nenit 19, par 1 të Ligjit nr. 03/L-222, dispozitë e cila parasheh se *“Aty ku Drejtori i Përgjithshëm beson se informatat e siguruara nga një person në deklaratën tatimore nuk paraqesin në mënyrë të saktë detyrimin e tij tatimor, ose kur tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar me këtë ligj, Drejtori i Përgjithshëm mund të bëjë një vlerësim të detyrimit të tij tatimor, përfshirë, por duke mos u kufizuar në, vlerësimet që rezultojnë nga përdorimi i faturave apo transaksioneve false.....”*, prandaj e paditura sipas këtij neni ka vlerësuar se transaksionet në mes të këtyre bizneseve nuk kanë ndodhur, andaj edhe nuk i ka njohur për qëllime të zbritjes së obligimit tatimor. Tutje e paditura kontestin e këtu paditësit për faturat lidhur me periudhën 2012 – 2014, e ka bazuar në faktin se për këto blerje kontestuese, tatimpaguesi këtu paditësi nuk ka arritur t’i vërtetoj me akte të tjera të parapara ligjore si deklarim të blerjeve mbi 500 euro, siç parashihet me paragrafin 3 të nenit 47, të Ligjit 03/L-222, me të cilin përcaktohet se : *“Të gjithë personat e angazhuar në tregti ose afarizëm të cilët taten në bazë të të hyrave reale dhe që bëjnë blerje të mallrave ose shërbimeve (apo marrin mallra ose shërbime në një tjetër transaksion) nga personi tjetër i tatueshëm në gjithsejtë pesëqind (500) Euro e më shumë në çdo vit të tatueshëm, duhet të paraqesin deklaratë të vërtetë dhe të saktë duke raportuar blerjet e tilla tek ATK-ja.....”*. Në fund e paditura në vendimin kontestues ka konstatuar se kontrolli pranë këtu paditësit është hapur sipas kërkesës së tatimpaguesit këtu paditësit për korrigjimin e deklaratave të sugjeruara nga Njësia e Hetimeve pranë ATK-së, në mënyrë që të kthej TVSH-në e rimbursuar në mënyrë jo të drejtë andaj bazuar edhe nenin 12, par 6, si dhe nenin 23, par 1, 2 dhe 3 të Ligjit 03/L-222, si dhe neneve 13, 14 dhe 16 të UA nr. 15/2010, transaksionet e kryera me bizneset e lartë cekura nuk do të njihen nga ATK-ja këtu

paditësit për qëllime të shpenzimit në një deklaratë tatimore të të ardhurave apo kërkesës për rimbursim të TVSH-së.

Gjykata me propozim të palës paditëse në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka ftuar ekspertin financiar M.P. i cili ka sqaruar se: *Në faqen tre të ekspertizës financiare të dt 11.12.2018 është përshkruar procedura administrative për të cilën unë kam qenë i angazhuar si ekspert i financiar. Pra ekspertiza financiare ka të bëjë me raportin e kontrollit të datës 17.11.2015 bazuar në objektin e dhënë për ekspertizë. Tutje ka sqaruar se i ka vërtetuar transaksionet bankare duke shtuar se në faqen e shtatë të ekspertizës të kërkesa 2 e ka cekur se në seancën e datës 23.12.2015 të organizuar nga ATK –DA inspektori deklaron se transaksionet bankare kanë ndodhur (faqja tre e raportit të ATK-DA). Në pyetjen e të paditurës nëse i ka patur provat materiale, respektivisht transaksionet të cilat konstaton se kanë ndodhur ka sqaruar se i ka verifikuar dhe plus konsideroj që një deklaratë e tillë e inspektorit është fakt plotësues. Ndërsa në pyetjen nëse ka ndodhur transaksioni i njëjti është përgjigjur se: *Në të njëjtën faqen 7 të ekspertizës gjithashtu është deklarimi i inspektorit të kontrollit se faturat kanë ekzistuar gjatë kontrollit të kryer dhe për të cilat nuk kanë pasur vërejtje. Sipas vlerësimit të ekspertit financiar vlerësimi se ndonjë aktivitet është fiktiv nuk bazohet së pari në pagesat e kryera por bazohet së pari në transaksionet e kryera. Për sqarim si bankier i vjetër duhet të bëhet dallimi si transaksion bankar dhe transaksionit ekonomik. Prapë në faqen shtatë të ekspertizës, bazuar në faktet e gjetura në dosjen për ekspertizë eksperti financiar ka konstatuar se faturat e ‘‘dyshimta’’ janë të regjistruara në librin e blerjeve sipas datave të ngjarjeve (aktivitet) të ndodhura, siç kërkohet me legjislacionin tatimor të përshkruar në këtë faqe.**

Eksperti me tej ka deklaruar se : *“Gjatë procedurës së analizës së dokumentacionit është vërejtur se kontrolli është hapur me kërkesë të ndërrimit të statusit të biznesit, ndërsa më vonë si nga ana e kontrollit ashtu edhe nga ana e ATK-DA janë thirrur në informatat/sugjerimet e NJHT pa përmendur askund dokumentin apo rekomandimin në të shkruar të NJHT. Për këtë qëllim eksperti financiare ka bërë kërkesë ATK që të prezantojë ekspertit informatat e NJHT për subjektet nga të cilat nuk duhet pranuar transaksionet. Edhe pas kërkesës së përsëritur lidhur me informatat e NJHT inspektori nuk ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim. Këto konstatime i gjeni në faqen katër të ekspertizës. ”* Ndërsa lidhur me pyetjen e përfaqësuesit të të paditurës se *A ka mundësi vetëm të na sqaroni pjesën ku ju keni konstatuar në ekspertizë se për të gjitha faturat hyrëse ka pasur edhe fatura dalës se dhe i gjithë malli i cili është blerë nga ana e paditësit është shitur përmes realizimit të projekteve sipas kontratave publike që i njëjti ka*

pasur me institucione publike. Eksperti financiar M.P. ka deklaruar se Përgjigje në këtë pyetje respektivisht sqarim e gjeni në faqen 4 të ekspertizës paragrafi i fundit. Ku T/P ka deklaruar që faturat dalëse janë si pjesë e projekteve, mirëpo sa më kujtohet mua, pasi që kam në dispozicion vetëm shtatë faqe të ekspertizës, nuk mundet të deklarojë me siguri se kam dhënë një vlerësim të tillë.

Gjykata konstaton se ekspertiza e punuar nga eksperti M.P. është e punuar në raport me raportin e kontrollit i atakuar në vendimin kontestues. Deklarimeve të ekspertit financiar të dhëna gjatë seancës si dhe ekspertizës së punuar nga i njëjti gjykata i fali besimin, kjo për faktin se me konstatimet e ekspertit në ekspertizë dhe sqarimeve në seancën gjyqësore është konstatuar se transaksionet kanë ndodhur më të vërtetë siç pretendon këtu paditësi, se malli është dorëzuar se faturat janë të regjistruara në librat e paditësit, se transaksioni ka ndodhur dhe mallrat e blera janë shitur tutje, respektivisht projektet janë realizuar.

Tutje Gjykata konstaton se e paditura nuk ka aplikuar drejt dispozitat ligjore neni 37 paragrafi 2 i Ligjit 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, që parasheh: *Për të ushtruar të drejtën e tij për zbritje të TVSH-së së zbritshme, personi i tatueshëm duhet që së paku: 2.1. në lidhje me të gjitha zbritjet e referuara në Kapitullin e XIII të këtij ligji të mbajë një faturë ose një dokument që shërben si faturë në pajtueshmëri me Kapitullin XV të këtij ligji.* Gjykata vlerëson se të gjitha faturat e blerjes nga paditësi, kanë qenë të regjistruara në librat e blerjes, pagesat e tyre janë bërë përmes bankës, subjekti i cilë i kanë lëshuar këto fatura kanë pasur certifikata valide në kohën e lëshimit të tyre. Për më tepër, vet e paditura në vendimin kontestues e ka përdorur termin të dyshuara, se transaksionet me bizneset në fjalë janë dyshuar se janë fiktive, andaj në këtë drejtim, gjykata vlerëson se nuk mund të cilësohen subjektet të dyshuara apo fiktive, ato subjekte përderisa kanë pasur certifikata valide të regjistrimit të biznesit, certifikatat e numrit fiskal të lëshuar nga vet e paditura, dhe kanë pasur certifikatat valide të TVSH-së të lëshuara, gjatë transaksioneve të blerjeve kontestuese.

Arsyetim i të paditurës është tërësisht i pa qëndrueshëm për gjykatën sepse paditësi nuk mund të mbajë përgjegjësi dhe të sanksionohet pse shitësit e furnizimeve të shërbimit ose mallit nuk i kanë deklaruar dhe paguar detyrimet tatimore, sepse përgjegjësi për deklarim dhe pagesë të tatimeve është e ndarë dhe ju përket vetëm personave përgjegjës të personave fizik, juridik, ortakërive të cilat ushtrojnë aktivitetet ekonomik sipas ligjit dhe kjo përcaktohet në nenin 16 të

Ligjit nr.03/L-222. Paditësi ka praqitur transferet bankare përmes të cilave vërtetohet se janë realizuar pagesat për faturat kontestuese.

Gjykata konstaton se çështja e mos pranimit të shpenzimeve për tatim në të ardhura, apo kreditimit në TVSH është rregulluar me nenin 23 par.6 të UA nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit nr.03/L-222 ku në mënyrë taksative është përcaktuar se *“Sikurse është paraparë në paragrafin 9 të Nenit 19 të Ligjit, nuk do të njihet asnjë shpenzim për qëllime të tatimit në të ardhura, apo qëllime të kreditimit në TVSh, si rezultat i transaksioneve me: 6.1.tatimpaguesit të cilët asnjëherë nuk janë regjistruar në ATK dhe nuk kanë numër fiskal; 6.2. tatimpaguesit të cilët janë çregjistruar në përputhje me dispozitat e Nenit 12 të këtij Udhëzimi Administrativ; 6.3. tatimpaguesit të cilët janë de-aktivizuar në përputhje me Nenin 13 të këtij Udhëzimi Administrativ; 6.4. bizneset të cilat janë regjistruar në ARBK, por nuk mund të gjenden në adresat e përdorura në atë regjistrim, apo çdo dokument regjistrimi të ofruar ATK-së, që rezulton në mos lëshimin e një numri fiskal; apo 6.5. tatimpaguesit të cilëve u është anuluar apo tërhequr certifikata e TVSh-së (lidhet vetëm me kreditimin e TVSh-së)”*. Ndërsa në paragrafin 7 të nenit 23 të UA nr.15/2010 është parashikuar se *“Data nga e cila shpenzimet nuk do të njihen për qëllime të tatimit në të ardhura, apo qëllime të kreditimit në TVSh, do të jetë ajo datë në të cilën ATK vendos në faqen e internetit njoftimin publik të faktit se transaksioni nuk do të njihet për shpenzime të tatimeve në të ardhura apo qëllime të kreditimit në TVSh. Njoftimi publik do të përmbajë një deklaram se transaksionet nuk do të njihen pas datës së specifikuar.”* Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk plotësohen asnjëri nga kushtet e parapara me paragrafin 6 të nenit 23, në mënyrë që paditësit të mos i pranohet TVSH-ja e zbritshme për faturat e blerjes nga subjektet e lart cekura, për arsye se subjektet kanë qenë të regjistruar në ATK dhe kanë pasur certifikata të TVSH-së, andaj gjykata nga shkresat e lëndës konstaton se ATK-ja këtyre subjekteve i ka lëshuar numrat fiskal, dhe se ia ka anuluar certifikatën e TVSH-së në periudhën kohore të mëvonshme, por jo para datës kur paditësi ka zhvilluar transaksione me këto subjekte.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është plotësisht i bazuar dhe i drejtë dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore. Paditësi qysh në fazën e kontrollit por edhe gjatë fazës së ankimimit ka paraqitur dokumentacion të harmonizuar për të dëshmuar pretendimet e tij si në padi, fakt ky jo kontestues, mirëpo e paditura nuk i ka marrë për bazë faturat dhe transaksionet bankare dhe në mënyrë krejt arbitrare ka obliguar paditësin më tatim shtesë por duke mos vërtetuar faktin se si

ka ardhur deri tek një vlerësim i tillë, ashtu që pa bazë ligjore nuk i ka pranuar faturat dhe transaksionet e realizuara me subjektet të cilat subjekte kanë poseduar certifikatë të vlefshme në periudhën e lëshimit të faturave kontestuese, e paditura në këtë rast ka konstatuar gabimisht gjendje tjetër faktike. Prandaj, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 81, par 2, nën par 2.2 të ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 46 par.5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'ia kthej shumën e paguar më tepër në emër të tatimit shtesë dhe t'ia njeh shumën e lartcekur në emër të zvogëlimit të kreditimit.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike të konstatuar më lartë, ballafaqimit të provave në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të vendimit kontestues, gjykata vlerësoi se organi i paditur ATK-së ka nxjerr konkluzion jo të drejt në pikëpamje të gjendjes faktike lidhur me transaksionet e faturave tatimore për periudhën 2012-2014, gjykata ka vendosur vetë në këtë konflikt administrativ ashtu që ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar vendimin nr.520/2019 të datës 31.12.2019 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, duke e obliguar të paditurën Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditësit NTL “NAS System” me seli në Gjilan, t'i kthej shumën prej 28.580.05 euro në emër të tatimit shtesë (PD- tatimi në Burim dhe TVSH- Tatimi në Vlerën e Shtuar, të vendosur për periudhën 2012-2014) si dhe detyrohet e paditura t'ia njeh edhe shumën prej 8,470.21 euro në emër të zvogëlimit të kreditimit.

Rrjedhimisht, Gjykata konform nenit 46 par 4 me të cilin përcaktohet se “*Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar,*” vendosi që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa vendimin lidhur me obligimin si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi me të cilin e paditura obligohet të kthej mjetet e paguara nga paditësi e mori konform nenit 46 par 5 me të cilin përcaktohet se “*Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore.*”

Vendimi mbi kamatë në shumën e obliguar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori duke aplikuar dispozitën e nenit 57.4 të Ligjit nr.2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me të cilën përcaktohet se “Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t’i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së 11 Financave dhe Ekonomisë” dhe dispozitën e nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se “Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t’i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të cekurat më lart gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 46 par.5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.59/2024 datë 07.05.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.